



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 296<sub>3</sub> Prot.

Tiranë më, 21/09 2021

**VENDIM**

**Nr. 15, datë 21.09.2021**

**“Për një ndryshim në ndarjen e buxhetit të ASA-së në zëra specifike, për fondet që kanë lidhje me buxhetin e shtetit.”**

Në bazë të nenit 49, pika “c” e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve në ndarjen e buxhetit të ASA-së në zëra specifike, për fondet që kanë lidhje me buxhetin e shtetit, sipas tabelës bashkëngjitur. Për zerin e shpenzimeve “Botimi”, të fillojë procedura e prokurimit pas marrjes së Titujve për botim me Vendim Senati, me specifikimet teknike përkatëse.
2. Miratimin e Relacionit të vlerësimit Nr. 207/1 Prot date 15.09.2021 të vlerësimit për paisjet informatike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas paraqitjes pranë Bordit të Administrimit të ASA-së të Vendimit të Senatit Akademik për listën e plotë të botimeve.
4. Ngarkohet Administratori i ASA për zbatimin e këtij vendimi.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**EMIS ÇERAVA**

